



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE SHKALLA E PARË

VLORË

Nr.663Akti
Datë 25.02.2016

Nr.480 Vendimi
Datë 05.04.2016

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Administrative e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë nga:

GJYQTARE: Gentiana XHELILI

asistuar prej sekretares gjyqësore Edlira Shehu, sot më datë 05.04.2016 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative me nr.663 Akti, që u përket palëve:

PADITËS: Subjekti person fizik Mimoza Shehu me seli në Vlorë, me nr-K76715202P NUIS, e përfaqësuar nga Mimoza Shehu, e bija i Qenan, e datëlindjes 02.12.1963, lindur dhe banues në Vlorë, me adresë, lagja "Pavarësia", rruga "Shyqyri Alimerko", përfaqësuar në gjykim me deklaram në seancë gjyqësore nga av.Gentian Hajdini me nr.1357 license dhe me nr-L06307205E NUIS.

I PADITUR:1-Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë,(*në mungesë*).

2-Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë,(*në mungesë*).

Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Vlorë, (*në mungesë*).

OBJEKTI:1- Shfuqizim akti administrativ vendim nr.35663/3.prot date 04.02.2016 e Drejtorise se Apelimit Tatimor.

2-Shfuqizim akti administrativ nr.12465 date 06.10.2015 i Drejtorise Rajonale të Tatimeve Vlore "*Njoftim uleresimi per detyrimet*".

BAZA LIGJORE:Neni 32/a, neni 154 e vijues i K.Pr.Civile, K.Pr.Administrative, Ligji me nr.49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", Ligji nr.9920 date 19.05.2008 "*Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise*" i ndryshuar, Udhezimi nr.24 datë 02.09.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar.

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore, u dëgjuar pala paditëse subjekti person fizik Mimoza Shehu përfaqësuesi i saj av.Gentan Hajdini i cili kërkoi nga gjykata pranimin e

kërkesë padisë, pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, nuk u dëgjua dhe nuk kanë paraqitur prapësime apo konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate, pasi ka vijuar gjykimi në mungesë të saj me gjithë njoftimin e rregullt që ka pasur për procesin gjyqësor, pala pjesëmarrëse në gjykim Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlorë nuk u dëgjua dhe nuk ka paraqitur konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate, pasi ka vijuar gjykimi në mungesë të saj me gjithë njoftimin e rregullt që ka pasur për procesin gjyqësor dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Se pala paditëse subjekti person fizik Mimoza Shehu i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesë padinë me objektin e mësipërm.

Përpara shqyrtimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë në prova të kërkesë padisë, gjykata konstatoi se në bazë të neneve 7,10,11 të ligjit me nr.49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"* çështja objekt gjykimi hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Në bazë të nenit 7 dhe 12 të ligjit me nr.49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"*, gjykimi u zhvillua me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtarë.

Rrethanat e faktit:

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se pala paditëse Mimoza Shehu është e regjistruar si subjekt person fizik i pajisur me nr-K76715202P NUIS, me adresë të aktivitetit në lagjen, "Pavarësia" Vlorë, me objekt veprimtarie *"Agjensi doganore spedicion"*.

Rezulton se në datë 09.09.2015 nga inspektorët e palës së paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë është ushtruar kontroll pranë palës paditëse ku është mbajtur akti i konstatimit me nr.0214844 serie date 09.09.2015 ku është konstatuar se *"pranë subjektit është gjetur në punë shtetasi Petrit Shehu, ku subjekti person fizik Mimoza Shehu është i regjistruar në Q.K.R dhe se është i pajisur me kasë fiskale"*.

Nga pala e paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë është nxjerre njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore me nr.12465 prot datë 06.10.2015 për paditëse subjekti person fizik Mimoza Shehu i pajisur me nr-K76715202P NUIS ku është sanskionuar me gjobë në masën 50.000(*pesëdhjetë mijë*) lekë, për shkak se ka të punësuar të padeklaruar në organin tatimor, veprimi i cili vjen në kundërshtim me nenin 119, pika a të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 *"Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"*.

Paditësja pasi ka marrë dijeni për njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore me nr.12465 datë 06.10.2015 ka ushtruar ankim administrative ndaj tij në datë 06.11.2015 pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme Tatimeve Tiranë.

Nga Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë me shkresën me nr.35663/3 prot datë 04.02.2016 është vendosur "lënia në fuqi i aktit administrative njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore me nr.12465 datë 06.10.2015 i nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë".

Paditësja subjekti person fizik Mimoza Shehu duke mos qenë dakort me njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore me nr.12465 datë 06.10.2015 i lëshuar nga pala e paditur, i është drejtuar me kërkesë padi gjykatës duke pretenduar se:

Së pari; paditesi ka qenë subjekt tregtar, person fizik me emrin tregtar Mimoza Shehu me seli ne Vlorë i themeluar ne date 15.05.2007, sipas ekstraktit historik te regjistrit tregtar te leshuar prej QKR Vlore me veprimtari agjensi doganore spedicionimi.Pala paditese ne date 09.09.2015 eshte kontrolluar nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore , si vertetohet nga Akt-konstatimi nr.0214844 date 09.09.2015, i mbajtur nga 3 inspektore , ne te cilen thuhet se "objekti i kontrollit ka qene lufta kunder informalitetit, dhe Z.Petrit Shehu u ndodh ne zyre ne momentin e kontrollit, por nuk eshte punonjes i zyres. Ishte per te terhequr licensen e axhentit doganor qe do te dorezohet ne Drejtorine e Doganave per NIPTIN e ri."

Nga ana e pales se paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore eshte leshuar akti administrativ "Nofitim vleresimi per detyrimet" nr.12465 date 06.10.2015 per gjobe ne masen 50.000 leke per subjektin Mimoza Shehu me NIPT K76715202P me adrese ne Vlore.

Paditesja brenda afatit ligjor i eshte drejtuar me ankim administrativ Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, Drejtorise se Apelimit Tatimor , duke parashtruar se qenia ne ambientet e zyres , nuk do te thote qe je duke punuar aty. Bashkeshorti i pales paditese u ndodh aty per te marre dokumentacionin e duhur per te terhequr ligensen e axhentit doganor qe do te dorezohej ne Drejtorine e Pergjithshme te Doganave (ne lidhje me garancine bankare), pasi nga ana e pales paditese do te mbyllej-aktiviteti, si vertetohet per gjoben. Kete pretendim , paditesja e provon me Vertetimin e kryerjes se aplikimit date 22.09.2015 te QKR Vlore "per çregjistrim personi fizik" ne emer te Mimoza Shehu me NIPT K76715202P.

Me shkresen nr.35663/1.prot date 05.01.2015 te Drejtorise se Apelimit Tatimor drejtuar paditesees i kerkohet kesaj te fundit plotesimi i dokumentacionit bashkangjitur ankimit administrativ, konkretisht fotokopjen e aktit administrativ, njoftim vleresimi per gjoben, me firme dhe vule te organit tatimor, fotokopje e process-verbalit te mabjtur nga inspektoret e kontrollit dhe formularin E-sig per deklarimin e punonjesit.

Ne date 20.01.2016 , pala paditese i ka kthyer pergjigje Drejtorise se Apelimit Tatimor, ku sqarohet se dokumentacioni i kerkuar prej saj eshte derguar njehere me apelimin e pare, por megjithate por ridergoheshin perseri prej saj.

Me shkresen nr.35663/3.prot date 04.02.2016 te Drejtorise se Apelit Tatimor eshte vendosur:

"Lenien ne fuqi te gjobes ne shumen 50.000 leke , percaktuar ne aktin administrativ, Njoftim Vleresimin per Detyrimet Tatimore, nr.12465 date

06.10.2015, vendosur nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Vlore, per mosdeklarim te nje punonjesi ne organin tatimor."

Si shkaqe per lenien ne fuqi te Njoftimit te Vleresimit per Detyrimet Tatimore, pala e paditur eshte mbeshtetur ne nenin 119/a te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar.

Së dyti; prej pales paditese ne zbatim te Ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, neni 106 dhe 107 eshte paraqitur ankimi administrativ ne Drejtorine e Apelimit Tatimor ne Ministrine e Financave.

Neni 106 dhe 107 parashikojne se: *Tatimpaguesi mund te ankimoje kunder gdo njoftim vleresimi, gdo vendimi qe ndikon ne detyrimin e tij tatimor, gdo kerkese per rimbursim ose lehtesim tatimor, ose gdo akti ekzekutiv te posagem tatimor, ne lidhje me tatimpaguesin; Ankimi behet me shkrim dhe ne formen e parashikuar ne zbatim te ketij ligji, me udhezim te Ministrit te Financave; Tatimpaguesi e dorezon ankimin ne drejtorine e apelimit tatimor brenda 30 diteve kalendarike nga data kur vleresimi ose vendimi i administrates tatimore eshte marre ose vleresohet te jete marre nga tatimpaguesi; Drejtoria e apelimit i dergon nje kopje te ankimit administrates tatimore, qe ka nxjerre vleresimin tatimor ose vendimin, objekt te ankimit tatimor.*

Neni 107 "Pagesa e detyrimit tatimor, objekt ankimi" ku parashikohet se *"Tatimpaguesi, i cili kerkon te ankimoje, si pas pikes 1 te nenit 106 te ketij ligji, duhet qe bashke me ankesen te paguaje shumen e plote te detyrimit tatimor ose te vendose garanci bankare per shumen e plote te detyrimit tatimor, te percaktuar ne njoftimin e vleresimit te administrates tatimore; Shuma e pagueshme ose shuma e vene si garanci bankare, sipas pikes 1 te ketij neni, perjashton gjobat e perfshira ne vleresimin tatimor te ankimuar; Ankimi merret ne shqyrtim vetem kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor, qe eshte objekt i ankimit, ose ka paraqitur dokumentin bankar qe verteton vendosjen e garancise, sipas percaktimit te pikave 1 dhe 2 te ketij neni; Akti administrativ, i leshtuar nga administrata tatimore dhe per te cilin nuk eshte ankimuar ne rruge administrative, nuk mund te ankimohet ne rruge gjyqesore.*

Neni 109 i ligjit parashikon se *"Vendimi i drejtorise se apelimit tatimor futet ne dosjen e tatimpaguesit dhe nga nje kopje i dergohet, me poste rekomande, tatimpaguesit dhe organit te administrates tatimore, qe ka bere vleresimin tatimor ose ka marre vendimin, qe eshte objekt i ankimit; Tatimpaguesi mund ta kundershtojte vendimin e drejtorise se apelimit tatimor ne gjykate, brenda 30 diteve kalendarike nga data e marrjes dijeni per kete vendim. Nese drejtoria e apelimit tatimor nuk shprehet brenda tre muajve nga data e marrjes se ankimit, tatimpaguesi mund te ankohet drejtperdrejt ne gjykate; Administrata tatimore, e cila ka nxjerre vendimin administrativ, objekt ankimi, mund ta apeloje vendimin e drejtorise se apelimit tatimor ne gjykate, brenda 30 diteve kalendarike nga data e marrjes dijeni per kete vendim; Per rivendosjen ne afat, zbatohen procedurat e parashikuara ne Kodin e Procedurave"; "Drejtoria e Apelimit merr masat per publikimin, ne ẽbsite-in e Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, te qendrimeve te mbajtura ne vendimet e marra prej saj".*

Së treti; Vendimi nr.35663/3 prot date 04.02.2016 i Drejtorise se Apelit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve eshte nje akt administrativ i nxjerre ne kundersizim me ligjin e posacem per keto arsye.

Në nenin 119 i ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar me ligji nr.10 209 date 23.12.2009 ka percaktuar se:"Nese nga verifikimi dhe kontrolli ne vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar ne organin tatimor gdo te punesuar rishtazi, te pakten 24 ore perpara fillimit te punes, perveg detyrimit per pagimin e shumes se kontributeve te papaguara, detyrohet te paguaje edhe nje gjobe prej 50 000 (pesedhete mije) lekesh, kur eshte subjekt i biznesit te vogel dhe 100 000 (njqind mije) lekesh, per biznesin e madh me TVSH, per gdo rast mosdeklarimi."

Ky nen eshte ndryshuar me ligjin nr.10415 date 07.04.2011 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" te ndryshuar qe parashikon: Mosdeklarimi i punonjesve Nese nga verifikimi dhe kontrolli ne vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar ne organin tatimor gdo te punesuar rishtazi, te pakten nje dite kalendarike perpara fillimit te punes, perveg detyrimit per pagimin e shumes se detyrimeve tatimore dhe kontributeve te sigurimeve shoqerore e shendetesore, te llogaritura nga data e konstatimit, denohet me gjobe per gdo punonjes te padeklaruar si me poshte: tatimpaguesit e regjistruar si subjekte te tatimit mbi vieren e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, gjobe prej 100 000 (njqind mije) lekesh; tatimpaguesit e tjere, gjobe prej 50 000 (pesedhete mije) lekesh.

Ligji nr.124/2012 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" te ndryshuar parashikon se: Ne nenin 119 "Mosdeklarimi i punonjesve", ne piken 1, shkronjat "a" dhe "b" ndryshohen si me poshte:"a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte te tatimit mbi vieren e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobe prej 500 000 (peseqind mije) lekesh; b) tatimpaguesit e tjere, me gjobe prej 250 000 (dyqind e pesedhete mije) lekesh."

Ligji nr.99/2015 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008, botuar ne Fletoren Zyrtare nr.187 date 28.10.2015 , neni 119 ka ndryshuar, duke u parashikuar se "Mosdeklarimi i punonjesve 1. Nese nga verifikimi dhe kontrolli ne vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar ne organin tatimor cdo te punesuar rishtazi, te pakten nje dite kalendarike perpara fillimit te punes, perveg detyrimit per pagimin e shumes se detyrimeve tatimore dhe kontributeve te sigurimeve shoqerore e shende-tesore, te llogaritura nga data e konstatimit, denohet me gjobe prej 500 000 (peseqind mije) lekesh.

Referimi, qe i ben pala e paditur denimit me gjobe , nenit 119/a te ligjit nr.9920 date 19.05.2008, nuk eshte i mbeshtetur ne asnje rresht te ligjit, dhe te ndryshimeve te sipercituara me lart.

Së katërti; pala e paditur, Drejtoria e Apelimit Tatimor i referohet ne faqen nr.2 te vendimit te saj, nenit 119, pika a te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" ku ajo citon nenin se "Nese nga verifikimi dhe kontrolli ne vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar ne organin tatimor, cdo

te punesuar rishtazi, te pakten 24 ore, perpara fillimit te punes detyrohet te paguaje nje gjobe prej 50.000 leke kur eshte subjekt i biznesit te vogel dhe 500.000 leke, per biznesin e madh me TVSH, per cdo rast mosdeklarimi."

Duke ju referuar ndryshimeve ne vite te nenit 119 te ligjit, shikohet qarte se gjoba nuk eshte vene ne baze te ligjit nr.99/2015 , i cili eshte botuar ne Fletoren Zyrtare nr.187 date 28.10.2015, duke qene se gjoba eshte e dates 09.09.2015.

Kjo gjobe nuk eshte vene as ne baze te ligjit nr.124/2012, pasi shumat e gjobave jane 250.000 per tatimpaguesit e tjere dhe 500.000 leke per tatimpaguesit si subjekte te pagimit te tatimit te vleres se shtuar dhe atij te fitimit.

Gjoba nuk ka qene as ne baze te ligjit nr.10415 date 07.04.2011, pasi dispozita flet per dite kalendarike , kurse referimi i pales se paditur flet per 24 ore para (termat e perdorura), si dhe pala e paditur i referohet subjekteve te biznesit te madh per gjobe 500.000 leke, kur nga permbajtja e nenit teresisht te ndryshuar, gjobat jane 100.000 leke dhe 50.000 leke.

Gjoba nuk eshte vene as ne baze te ligjit nr.10209 date 23.12.2009, pasi pala e paditur i referohet denimit me gjobe ne shumen 500.000 leke te reja per biznesin e madh dhe 50.000 leke per biznesin e vogel, kur ky ligj percakton shumen prej 100.000 leke te gjobes.

Si vertetohet nga ekstrakti i QKR Vlore, del qarte se pala paditese eshte person fizik me date themelimi 15.05.2007 me objekt te veprimtarise agjensi doganore spedicionimi me status mbyllur aktualisht e me Numer Unik i Identifikimit te Subjektit (NUIS) K76715202P.

Pala e paditur ka percaktuar apriori , qe bashkeshorti i subjektit fizik Mimoza Shehu eshte i punesuar, i padeklaruar, por nuk jepet asnje lloj prove ne funksion te ketij pretendimi. Si rezulton nga provat bashkangjitur, del se bashkeshorti Petrit Shehu, ka qene me detyre administrator dhe ortak i vetem i shoqerise "CO.BE.IN" sh.p.k dhe ka qene paguar prane kesaj shoqerie deri ne date 01.09.2015.

Fakti qe ndodhej ne ambientet e zyres nuk perben prove, qe bashkeshorti i paditeseve te jete i punesuar si pretendon pala e paditur. Gjithashtu edhe vendimi i Komisionit te Apelimit Tatimor perdor termin "falje", kur pala paditese nuk ka kerkuar faljen e gjobes se ka bere gabim, por shfuqizimin e saj per shkak te mosmbeshtetjes ne ligj.

Për sa me sipër paditësja subjekti person fizik Mimoza Shehu kërkoi nga gjykata pranimin e kërkesë padisë si të bazuar në ligj dhe në prova.

Pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë nuk u dëgjuan në këtë gjykim pasi është vijuar gjykimi në mungese të tyre me gjithë njoftimin e rregullt që kishte për procesin gjyqësor dhe nuk ka depozituar prapësime apo konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate.

Pala pjesëmarrëse në gjykim Avokatura Shtetit Zyra Vendore Vlorë nuk u dëgjua në këtë gjykim pasi është vijuar gjykimi në mungese të saj me gjithë njoftimin e rregullt që kishte për procesin gjyqësor dhe nuk

ka depozituar prapësime apo konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate.

Gjykata pasi ka administruar provat dhe ka analizuar në tërësi çështjen, çmon se kërkesë padia e paraqitur nga paditësja person fizik Mirela Toska është e pabazuar në ligj e prova dhe si e tillë do të rrëzohet.

Arsyetimi ligjor:

Në nenin 7, pika a të ligjit me nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se "Gjykata administrative janë kompetente për;

a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontrata administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga organi publik.

Në nenin 15 të ligjit me nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se ;Të drejtën e padisë e ka:

a) çdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik.

Në nenin 17 të ligjit me nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se ;Padia ngrihet;

a) për shfuqizimin teresisht apo pjeserisht të aktit administrativ.

Rezulton se pala paditëse **subjekti person fizik Mimoza Shehu** nuk ka një interes legjitim për të kërkuar anulimin e aktit administrativ të Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore me nr.12465 datë 06.10.2015 i nxjerrë nga pala e paditur Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, i lënë në fuqi nga Drejtoria e Apelimit Tatimor me nr.35663/3 prot datë 04.02.2016, pasi ky akt administrativ është nxjerrë në zbatim të ligjit.

Çështja objekt gjykimi rregullohet nga ligji me nr.9920, datë 19.05.2008 "**Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë**" (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Udhëzimi nr.24, datë 02.09.2008 "**Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë**" në nenin 68.3.1, pika c parashikon se "Kur personi i tatueshëm nuk ka respektuar detyrimin ligjor për të paraqitur deklaratën tatimore. Në këtë rast, vlerësimi i detyrimit tatimor të tatim paguesit nga administrata tatimore mund të bëhet direkt nga zyra, nëpërmjet përdorimit të metodave alternative të vlerësimit tatimor të përcaktuara në nenin 72 të ligjit dhe në këtë udhëzim.

Në nenin 72.1 të këtij udhëzimi parashikohen mënyrat alternative të vlerësimit tatimor sipas të cilit:

Në përdorimin e metodave alternative të vlerësimit tatimor administrata tatimore bazohet në dokumentacionin dhe informacionin që disponon, duke pasur parasysh edhe faktet dhe rrethanat konkrete të biznesit, me synim rikarakterizimin e transaksioneve dhe llogaritjen sa më të saktë të detyrimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi. Të dhënat

kryesore ku bazohet gjykimi i administratës tatimore, por pa u kufizuar vetëm në to, janë:

a) të dhëna direkte nga deklaratat tatimore të tatimpaguesit apo transaksione të tjera të ngjashme të tatimpaguesit;

b) të dhëna direkte, dokumentacione e informacione të marrë nga palët e treta;

c) të dhëna, dokumentacione e informacione të marrë nga transaksione të ngjashme të kryera nga tatimpagues të tjerë;

ç) të dhëna të tjera indirekte, si konsumi energjisë, karburantit, lëndëve të para, normativave të ndryshme, etj.,

d) çmimet e referencës së doganës, apo informacione mbi çmimet me pakicë që disponohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Në përdorimin e metodave alternative mbahen parasysh edhe dispozitat e pikës 51.3 të këtij Udhëzimi.

Nga ky përcaktim që bën Udhëzimi "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" rezulton se Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë ka kryer një vlerësim tatimor nga zyra duke u bazuar në të dhëna direkte të marra nga persona të tretë.

Kështu rezulton që Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë ka verifikuar nëse punonjësit ishin të siguruar ose jo dhe nga verifikimi ka rezultuar se shtetasi Petrit Shehu, ku në gjykim nuk rezultoj e provuar që punonjësi të ishte i siguruar në Sigurime Shoqërore.

Në nenin 119 të ligjit me nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) parashikohet se "1.Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar si më poshtë: a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin me gjobë prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh; **b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.**

Çdo konstatim i përsëritur i mosdeklarimit të punonjësve, pas aplikimit të dënimit administrativ, si në pikën 1, të këtij neni, konsiderohet evazion tatimor, sipas nenit 116 të ligjit, dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të këtij ligji, duke e bërë kallëzimin penal për tatimpaguesin.

Rezulton se punonjësi Petrit Shehu duhet të ishte deklaruar një ditë më parë se të fillonte punën pranë subjektit personit fizik Mimoza Shehu me nr- K76715202P NUIS.

Sa më sipër, gjykata çmon se "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore me nr.12507 prot datë 06.10.2015 i marrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë si dhe vendimi nr.35473/1datë 05.01.2015 i Drejtorisë së Apelit Tatimor" janë vendime të nxjerra në zbatim me ligjit me nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) dhe akteve nën ligjore të nxjerrë në zbatim të tij.

Për këtë arsye, Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore me nr.12465 datë 06.10.2015 i nxjerrë nga pala e paditur Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, i lënë në fuqi nga Drejtoria e Apelit Tatimor me nr.35663/3 prot datë 04.02.2016 është një akt administrativ i vlefshëm pasi ka dalë në zbatim të ligjit të posaçëm "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar) dhe padia e paditëses duhet të rrëzohet si e pabazuar në ligj dhe në prova.

Në rastin objekt gjykimi akti që kundërshtohet ka një vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi, 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe ku për rrjedhojë duke patur parasysh se e drejta e ankimit rregullohet me ligj në këtë rast gjen zbatim dhe duhet të mbahet parasysh neni 45 i ligjit me nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" dhe për këtë arsye ky vendim është i paankimueshëm.

Në zbatim të nenit 106 të K.Pr.Civile shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.

Sa më sipër, gjykata çmon se kërkesë padia e paditëses subjekti Mimoza Shehu është e pabazuar në ligj e në prova dhe si e tillë duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 40 dhe 41 të ligjit me nr.49/2012 "***Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative***", nenet 306-310 të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

1-Rrëzimin e kërkesë padisë.

2-Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.

3-Kundër këtij vendimi nuk parashikohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

U shpall në Vlorë, sot më datë 05.04.2016

SEKRETARE

Edlira **SHËHU**

SHPENZIMET GJYQËSORE

Taksa e rregjistrimit
Njoftime
TOTALI

3.000 (tre mijë) lekë.

240 (dyqind e dyzet) lekë.

3.240 (tre mijë e dyqind e dyzet) lekë.

GJYQTARE

Gentiana **XHELILI**